



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Pjesa II: Raport vlerësimi mbi aplikimin e drejtësisë procedurale në tetëmbëdhjetë degët e gjykatave në Kosovë

Maj 2023





**PJESA II: RAPORT
VLERËSIMI MBI APLIKIMIN E
DREJTËSISË PROCEDURALE
NË TETËMBËDHJETË DEGËT
E GJYKATAVE NË KOSOVË**

AUTORJA:

Dr. Albana Rexha



Vizitoni faqen tonë
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimin tonë të fundit,
lajmet, infografikat online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@Democracy-Plus](https://www.youtube.com/Democracy-Plus)

Zyrat tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Mohim i përgjegjësishë: Ky raport është mundësuar me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është në përgjegjësi të vetme të Demokraci Plus dhe nuk paraqet medoemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përmbajtja

Hyrje	6
Metodologjia	7
Të dhëna demografike	8
Të gjeturat kryesore.....	9
Rezultatet e anketës së vëzhgimit të përvojës në gjykatë.....	13
Rekomandimet.....	22
SHTOJCA I	23

Hyrje

Ky vlerësim është vazhdim i hulumtimit të mëparshëm me titull “Raport vlerësimi mbi aplikimin e drejtësisë procedurale në shtatë gjykatat themelore të Kosovës”. Sikurse edhe titulli sugjeron, vlerësimi i mëhershëm ka mbuluar vetëm shtatë gjykatat themelore në Kosovë, ndërsa ky vlerësim mbulon tetëmbëdhjetë (18) degët e gjykatave, atë në Istog, Lipjan, Dragash, Glllogoc, Malishevë, Vushtrri, Skënderaj, Kaçanik, Rahovec, Kamenicë, Deçan, Suharekë, Novobërdë, Viti, Podujevë, Shtërpçë, Graçanicë dhe Klinë. Ky është vlerësimi i parë i këtij lloji për 18 degët e sipërpërmendura të gjykatave dhe mbështetet nga Projekti i USAID-it për Drejtësinë në Kosovë.

Ky hulumtim vlerëson zbatimin e drejtësisë procedurale në tetëmbëdhjetë (18) degët e gjykatave, bazuar në gjetjet e Anketës së vëzhgimit të përvojës në gjykatë, e realizuar nga D+. Anketa e vëzhgimit të përvojës në gjykatë (anketa), është realizuar brenda ndërtesës së gjykatës, në sallë të gjykimit ose në zyrë të gjyqtarit, gjatë periudhës tetor-nëntor 2022. Anketa përmban 18 pyetje të përmbledhura në Shtojcën I. Rezultatet e anketës shërbejnë si provë për degët e gjykatave për përmirësimin e zbatimit të drejtësisë procedurale.

Projekti i USAID-it për Drejtësi është program pesëvjeçar që ka për qëllim forcimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë duke aplikuar një qasje të drejtësisë me qytetarin në qendër, me qëllim të përmirësimit të kapacitetit institucional për t'u siguruar qytetarëve qasje në shërbime cilësore dhe forma të ndryshme për zgjidhjen e nevojave të tyre të drejtësisë dhe problemeve të përditshme ligjore, si dhe për të rritur besimin publik në sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit. Ky aktivitet do ta arrijë këtë përmes tri objektivave të ndryshme por që ndërliken ndërmjet vete:

- Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes së shërbimeve të drejtësisë. Mbështetja e përmirësimit të qasjes së qytetarëve në drejtësi përmes rritjes së drejtësisë procedurale, zgjerimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe vazhdimit të përmirësimit të politikave dhe praktikave të administrimit dhe menaxhimit në gjykata. Përmes këtyre përpjekjeve, aktiviteti do të mbështesë institucionet e Kosovës dhe akterët kryesorë për të kuptuar nevojat me prioritet të qytetarëve për të përmirësuar me-

kanizmat ekzistues ose për të identifikuar masa të reja, që të sigurojë që të gjithë qytetarët marrin shërbime të drejta dhe të paanshme, si dhe të kuptojnë më mirë të drejtat e tyre ligjore dhe procedurat gjyqësore.

- Përmirësimit të të kuptuarit, angazhimit dhe besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Komunitetet dhe praktikuesit do të angazhohen në përkufizimin e problemeve dhe propozimit të përmirësimeve për realizimin e shërbimeve ligjore dhe informacionit për kërkuesit e ndryshëm të drejtësisë aty ku jetojnë dhe në çështjet me të cilat përballen. Duke punuar përmes institucioneve përgjegjëse të Kosovës, aktiviteti lehtëson forumet e praktikuesve, duke përfshirë komunitetin e praktikës për zyrtarët e informimit publik, për të institucionalizuar burimet kritike dhe praktike për angazhimin me përdoruesit e gjykatës në kërkimin e komenteve dhe komunikimit të tyre dhe ndarjen e informacionit mbi ofrimin e shërbimeve të drejtësisë.
- Zhvillimi i inovacionit efektiv në sektorin e drejtësisë. Mbështetet zhvillimi i një Inkubatori për Inovacion në Drejtësi që do të ndihmojë të drejtohet kapaciteti për inovacion bazuar në sfidat me të cilat përballen institucionet e drejtësisë dhe përdoruesit e saj. Në paradigmen e drejtësisë me qytetarët në qendër, këto inovacione do të rrisin mirëdashjen e përdoruesve të politikave dhe procedurave, do të rrisin përbalueshmërinë dhe qasjen në shërbime të drejtësisë, ose do të përmirësojnë ndjenjat e kërkuesve të drejtësisë në paanësi dhe besim në sistemin e drejtësisë.

Democracy Plus (D+) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, dhe jopolitike e themeluar nga një grup aktivistësh të cilët besojnë në forcimin e mëtejshëm të vlerave demokratike në Kosovë. Qëllimi kryesor i D+ është fuqizimi i vlerave dhe praktikave demokratike që do të forcojnë më tej zërin e shoqërisë kosovare. D+ synon të kontribuojë në krijimin e praktikave të qeverisjes së mirë, forcimin e sundimit të ligjit, ndihmën për procesin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, si dhe nxitjen e respektimit të të drejtave të njeriut dhe çështjeve sociale. D+ ka zbatuar projekte të ndryshme që synojnë t'i sjellin vendimmarrësit më pranë qytetarëve përmes hulumtimit të politikave, lehtësimit të dialogut dhe ndërveprim-it, si dhe aktivitetet e edukimit publik.

Metodologjia

D+ ka realizuar Anketën e vëzhgimit të përvojës në 18 degët e gjykatave, duke përfshirë Istogun, Lipjanin, Dragashin, Glllogocin, Malishevën, Vushtrrinë, Skenderajin, Kaçanikun, Rahovecin, Kamenicën, Deçanin, Suharekën, Novobërdën, Vitinë, Podujevën, Shtërpcën, Graçanicën dhe Klinën.

Për realizimin e anketës, gjatë periudhës nga 18 tetori deri më 30 nëntor 2022, nga një anketues ka vëzhguar rastet gjyqësore në të gjitha degët e gjykatave. Lëndët gjyqësore janë vëzhguar në sallë të gjyqimit ose në zyrë të gjyqtarit. Të gjithë anketuesit janë trajnuar nga Qendra për Inovacion në Drejtësi në SHBA, me mbështetjen e Projektit të USAID-it për Drejtësi. Gjithashtu, të gjithë anketuesit janë trajnuar nga stafi i D+ disa ditë para fillimit të punës së tyre në terren dhe janë pajisur me tabletë elektronik. Përmes këtij trajnimit, ata janë pajisur me njohuri, shkathtësi dhe udhëzime për realizimin e anketës së vëzhgimit, ndërsa tableti elektronik mundësoi mbikëqyrjen në kohë reale të mbledhjes së të dhënave dhe verifikimin e vendndodhjes së shënimit.


Vëzhgimet në të gjitha degët e gjykatës janë kryer në shkallë prej 100% të gjyqtarëve që punojnë në dhomat civile dhe penale, përfshirë krimet e rënda, për t'i kapur së paku 2-3 orë vëzhgimi për gjyqtar. Në këto vëzhgime nuk janë përfshirë rastet e kundërvajtjes dhe të miturve, por as seancat e tjera të mbyllura për publikun, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Për më tepër, D+ ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përmes të cilit siguroi që të gjithë anketuesit mund të hyjnë në ambientet e gjykatës për realizimin e anketës pa vështirësi.

Në total, siç është paraqitur më poshtë, anketuesit e D+ kanë vëzhguar **533.38 lëndësh gjyqësore në 18 degë të gjykatave.**


■ Numri i orëve të vëzhgimit të rasteve gjyqësore për degë të gjykatës

Rajoni	Kohëzgjatja në orë
Deçan	35.22
Dragash	19.80
Glllogoc	23.72
Istog	30.00
Kaçanik	32.38
Kamenicë	39.32
Klinë	38.83
Lipjan	42.77
Malishevë	26.35
Novobërdë	42.03
Podujevë	31.40
Rahovec	44.78
Skenderaj	21.50
Suharekë	31.47
Viti	33.08
Vushtrri	27.65
Graçanicë	7.88
Shtërpçë	5.40
Gjithsej	533.58




Të dhëna demografike

Të dhënat e ndara sipas gjinisë së gjyqtarit tregojnë se në 83.28 % të rasteve gjyqësore të vëzhguara, kryetari i trupit gjykues ishte burrë dhe në 16.72 % të rasteve ishte grua.



Të dhënat e ndara sipas përkatësisë etnike të gjyqtarit tregojnë etninë e kryetarit të trupit gjykues.





Të gjeturat kryesore

Të gjeturat kryesore

Në përgjithësi, gjetjet sugjerojnë se degët e gjykatave janë duke bërë punë më të mirë për t'i mirëpritur njerëzit në sallën e gjykimit dhe kanë praktika më të mira të menaxhimit të kohës në krahasim me gjykatat themelore. Megjithatë, ka ende hapësirë për përmirësim, përfshirë në atë që gjyqtarët të prezantohen para palëve, të kërkojnë falje për vonesë, si dhe të sigurojnë që palët i kuptojnë rregullat e mirësjelljes në gjykatë. Nga ana pozitive, gjyqtarët përgjithësisht kanë shfaqur sjellje profesionale, duke mbajtur kontakt me sy me palët, duke iu referuar palëve me emër, si dhe kanë siguruar që palët i kuptojnë të drejtat e tyre ligjore dhe çfarë duhet të bëjnë për të vepruar në përputhje me pritshmëritë e gjykatës.

- Rezultatet e vëzhgimit në degët e gjykatave tregojnë se në 88.04% të rasteve të monitoruara, personat që hynin në sallën e gjyqit priteshin me mirësjellje nga stafi i gjykatës. Ky rezultat është më i lartë për 4.96 pikë përqindjeje në shtatë gjykatat themelore.¹ Këto të dhëna tregojnë se gjykatat themelore hulumtojnë mënyra për të përmirësuar rezultatet në kuptim të pritjes së qytetarëve në sallën e gjykimit.
- Në 91.29% të rasteve të vëzhguara, emri i gjyqtarit nuk ishte i dukshëm në bankë, që do të thotë se qytetarët që gjenden në gjykatë për ta përcjellë rastin mund të mos e dinë emrin e gjyqtarit. Vetëm në 8.71% të rasteve emri i gjyqtarit ishte i dukshëm, por kryesisht në zyrat e gjyqtarëve dhe jo në sallë të gjykimit. Ky rezultat është më i ulët se në gjykatat e tjera themelore për 25.75 pikë përqindjeje, ku emri i gjyqtarit ishte më i dukshëm në sallë gjykimi.
- Nga të dhënat rezulton se në 74.81% të rasteve të vëzhguara gjyqësore, seanca ka filluar në kohë, që është tregues pozitiv i proceseve gjyqësore në kohë dhe efikase. Për më tepër, kjo përqindje është më e lartë për 9.27 pikë përqindjeje në krahasim me rastet gjyqësore të vëzhguara në shtatë gjykatat themelore. Kjo sugjeron që degët e gjykatave kanë pasur praktika më të mira të menaxhimit të kohës sesa gjykatat themelore. Megjithatë, ka ende hapësirë për përmirësim, meqë më shumë se një e katërta e rasteve të vëzhguara nuk kanë filluar me kohë.
- Në 66.98% të rasteve të vëzhguara, gjyqtari është prezantuar, ndërsa në 33.02% jo. Megjithatë, në gjykatat themelore kjo nuk ishte paraqitur si sfidë, pasi gjyqtarët u prezantuan në 95.6% të rasteve të vëzhguara. Kjo sugjeron se mund të ketë vend për përmirësim për të siguruar se gjyqtarët prezantohen me emër në përqindje më të madhe të rasteve, pasi kjo mund të kontribuojë në krijimin e një mjedisi respektues dhe profesional në sallën e gjykimit.
- Në 60.92% të rasteve të vëzhguara, gjyqtari ka kërkuar falje për vonesën në fillim të seancës, ndërsa në gati 40% të rasteve, gjyqtarët nuk kërkuan falje për vonesën dhe nuk treguan respekt ndaj palëve. Të dhënat gjithashtu tregojnë se përqindja e gjyqtarëve që kanë kërkuar falje për vonesa në shtatë gjykata themelore është më e lartë për 13.08 pikë përqindjeje. Kjo sugjeron se ka hapësirë për përmirësim, në kuptim që gjyqtarët të tregojnë respekt ndaj palëve dhe të jenë transparentë për vonesat që mund të ndodhin në procedura gjyqësore.
- Në 92.17% të rasteve gjyqësore të vëzhguara, gjyqtari është kujdesur që t'i njoftojë të gjitha palët për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë procesit. Ky është aspekt i rëndësishëm i garantimit të drejtësisë dhe paanshmërisë në procesin ligjor, meqë ndihmon që të sigurohet që të gjitha palët i kupto-

1 Ju lutemi shih hulumtimin e Demokraci Plus: Raport vlerësimi mbi aplikimin e drejtësisë procedurale në shtatë gjykatat themelore në Kosovë (2022). Në dispozicion në <https://dplus.org/publikimet/raport-vleresimi-mbi-aplikimin-e-drejtises-procedurale-ne-shtate-gjykatat-themelore-te-kosoves/13384/>

jnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore. Megjithatë, në një numër të vogël rastesh (7.83%), gjyqtari nuk e ndau këtë informacion të rëndësishëm me palët, gjë që do të mund të çonte në mungesë të të kuptuarit dhe pamundësi të ngritjes së zërit për palët e përfshira në rast.

- Në 74.39% të rasteve të vëzhguara, gjyqtari ose personeli tjetër i gjykatës ka shpjeguar rregullat e mirësjelljes në fillim të seancës gjyqësore. Megjithatë, kjo përqindje është më e ulët se ajo e vërejtur në gjykatat themelore për 22.51 pikë përqindjeje. Kjo sugjeron se mund të ketë nevojë për përmirësim në degët e gjykatave për të siguruar që palët e kuptojnë procedurën dhe rregullat gjyqësore, që është thelbësore për drejtësinë procedurale.
- Në 84.87% të rasteve të vëzhguara, gjyqtarët kanë bërë përmbledhje të procesit të seancës dëgjimore, përfshirë informata mbi seancën aktuale dhe procesin e përgjithshëm të gjykimit të rastit. Megjithatë, ky rezultat ishte më i ulët për 10.13 pikë përqindjeje krahasuar me gjykatat themelore ku gjyqtarët kanë bërë përmbledhje të tillë në një përqindje më të lartë të rasteve. Kjo tregon se gjykatat themelore mund të jenë më efektive për të siguruar që palët kanë kuptuar qartë procesin dëgjimor dhe rolin e tyre në të.
- Në 96.93% të rasteve të vëzhguara gjyqësore, gjyqtarët kanë mbajtur kontakt me sy me palët gjatë seancës, që mund të shihet si aspekt pozitiv i drejtësisë procedurale. Mbajtja e kontaktit me sy tregon respekt për palët dhe ndihmon në krijimin e një atmosfere besimi dhe drejtësie në procedurat gjyqësore.
- Në 98.84% të rasteve të vëzhguara, gjyqtarët kanë shfaqur sjellje profesionale, duke folur në mënyrë të qartë dhe të qetë. Kjo tregon se shumica dërrmuese e gjyqtarëve ishin në gjendje të mbanin sjellje profesionale gjatë kryerjes së detyrave të

tyre. Për më tepër, të dhënat sugjerojnë se kjo është gjetje e vazhdueshme në gjykata themelore, meqë rezultate të ngjashme janë vërejtur në shtatë gjykata themelore, ku 99.2% e gjyqtarëve kanë shfaqur sjellje profesionale.

- Në 92.17% të rasteve të vëzhguara gjyqësore, gjyqtari iu referua palëve të përfshira me emër. Kjo tregon se shumica e gjyqtarëve tregojnë respekt ndaj palëve duke iu drejtuar drejtpërdrejt, me emër, në vend që t'u referohen atyre në mënyrë të përgjithshme ose jopersonale.
- Në 96.72% të rasteve të vëzhguara gjyqësore, gjyqtarët u siguruan që palët e përfshira në lëndë i kuptojnë të drejtat e tyre ligjore. Kjo tregon se shumica dërrmuese e gjyqtarëve në këto raste kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar që palët ishin të informuara në tërësi dhe i kuptonin të drejtat e tyre ligjore përkitazi me rastin. Të dhënat sugjerojnë gjithashtu se kjo është gjetje e vazhdueshme, si në gjykatat themelore ashtu edhe në degë, me rezultat të përgjithshëm mbi 96%. Për më tepër, të dhënat tregojnë se rezultati është edhe më i lartë në gjykatat themelore, me rritje prej 2.08 pikë përqindjeje, që është indikacion se gjyqtarët në gjykatat themelore janë veçanërisht të aftë që të sigurojnë se palët i kuptojnë të drejtat e tyre. Në përgjithësi, kjo sjellje pozitive është tregues pozitiv i zotimit të sistemit të drejtësisë për të siguruar që të gjitha palët kanë qasje në drejtësi dhe i kuptojnë të drejtat e tyre.
- Në 91.64% të rasteve të vëzhguara gjyqësore, gjyqtarët u përshkruan qartas palëve se çfarë duhej të bënin për t'i përmbushur pritshmëritë, urdhrat e përkohshëm dhe/ose aktgjykimet. Kjo tregon se shumica e gjyqtarëve në këtë rast kanë bërë përpjekje të qartë për t'i shpjeguar palëve se çfarë pritet nga ta për t'i respektuar vendimet e gjykatës. Përveç kësaj, të dhënat tregojnë se në të gjitha gjykatat themelore, gjyqtarët e arritën këtë standard në 99% të rasteve të vëzhguara, që

është shenjë e një rritjeje të konsiderueshme prej 7.36% në krahasim me të dhënat e përgjithshme. Kjo sugjeron që gjyqtarët në gjykatën themelore mund të jenë veçanërisht të shkathët për t'i shpjeguar palëve se çfarë duhet të bëjnë për të respektuar vendimet e gjykatës dhe palët e përfshira mund të kenë shkallë të lartë të të kuptuarit.

- Në 92.7% të rasteve të vëzhguara, palët janë lejuar të shtrojnë pyetje apo bëjnë komente gjatë procedurës gjyqësore. Kjo tregon se palët janë lejuar të marrin pjesë në procedurë, që është aspekt i rëndësishëm për të siguruar proces të drejtë e transparent gjyqësor. Të dhënat gjithashtu tregojnë se, në gjykatat themelore, palët janë lejuar të bëjnë pyetje apo komente në 97.3% të rasteve, që përbën rritje prej 4.6 pikë përqindjeje në krahasim me të dhënat e përgjithshme. Megjithatë, si në gjykatat themelore ashtu edhe në degët e gjykatave, kjo nuk shihet si një sfidë madhore.
- Në 82.22% të rasteve të vëzhguara, gjyqtari u kërkoi palëve ta përsërisin të kuptuarit e palëve mbi rolin e tyre, veprimet e kërkuara/hapat e mëtejshëm, përfshirë tarifatat që duhej paguar, dokumentet e dorëzuara etj. Ky rezultat tregon se një pjesë e konsiderueshme e gjyqtarëve mund të

të mos i japin prioritet rëndësisë së garantimit që palët t'i kuptojnë në tërësi procedurat dhe rolin e tyre në to.


- Në 97.57% të rasteve të vëzhguara, gjyqtari ka përdorur gjuhë të thjeshtë për t'i shpjeguar termat juridikë ose shkurtesat, duke siguruar që palët e kuptojnë atë që thuhet në seancë. Rezultate të ngjashme pozitive janë treguar në gjykatat themelore, veçanërisht në 99% të seancave gjyqësore të monitoruara gjyqtari ka përdorur gjuhë të thjeshtë. Kjo është me rëndësi sepse procedurat ligjore shpeshherë mund të përfshijnë terminologji komplekse që mund të jetë e vështirë për t'u kuptuar nga personat që nuk janë juristë, prandaj dhe është thelbësore që palët ta kuptojnë plotësisht procedurën në mënyrë që të marrin pjesë në mënyrë efektive.
- Në 79.26% të rasteve gjyqësore të monitoruara, palët janë konsultuar se kur do të caktohet data e ardhshme, ndërsa në gjykatat themelore palët janë konsultuar në 76% të rasteve. Si në gjykatat themelore ashtu edhe në degët e gjykatave, kjo është paraqitur si sfidë.

Rezultatet e anketës së vëzhgimit të përvojës në gjykatë

Në këtë pjesë, rezultatet e pyetjeve të anketës së vëzhgimit të përvojës në gjykatë, janë interpretuar në të njëjtën renditje sikurse ajo në anketë (Shtojca I).

Pyetja e parë e anketës vëzhguese ka të bëjë me përshëndetjen e stafit të gjykatës për njerëzit që hyjnë në sallën e gjyqimit. Në 88.04% të rasteve të vëzhguara personat që hynin në sallën e gjyqimit janë përshëndetur nga stafi i gjykatës, ndërsa në 11.96% të rasteve nuk janë përshëndetur.


JO
113
11.96%



PO
832
88.04%


Një aspekt tjetër i vërejtur ishte dukshmëria e emrit të gjyqtarit. Rezultatet e monitorimit tregojnë se në 91.29% të rasteve emri i gjyqtarit nuk ishte i dukshëm në bankë, ndërsa ishte i dukshëm vetëm në disa raste (8.71%).

JO
618
91.29%




PO
59
8.71%


Për më tepër, rastet gjyqësore janë vëzhguar për të parë nëse seancat kanë filluar në kohë. Nga tabela mësohet se në 74.81% të rasteve seancat kanë filluar në kohë, ndërsa në 25.19% të rasteve nuk kanë filluar në kohë.




Nga të dhënat e vëzhgimit tregon se në 66.98% të rasteve gjyqtarja është prezantuar me emër, ndërsa në 33.02% jo.



Siç tregon tabela e mëposhtme, në 60.92% të çështjeve gjyqësore të monitoruara, gjyqtarët kanë kërkuar falje për vonesën në fillim të seancës duke treguar respekt për palët. Në anën tjetër, në 39.08% të seancave, gjyqtarët nuk kanë kërkuar falje për vonesën.




Të dhënat e vëzhgimit tregojnë se në shumicën e rasteve (92.17%) gjyqtarët kanë njoftuar palët për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë procedurës. Në anën tjetër, në një numër të vogël të rasteve gjyqësore (7.83%) palët nuk janë njoftuar për këtë.



Siç është paraqitur në tabelën 9, në 74.39% të rasteve të vëzhguara gjyqtari ose personeli tjetër i gjykatës qartas ka shpjeguar rregullat e mirësjelljes në fillim të seancës gjyqësore. Ndryshe, në 25.61% të rasteve gjyqësore të monitoruara, gjyqtari apo stafi tjetër i gjykatës nuk kanë dhënë një shpjegim të tillë.

JO
242
25.61%




PO
703
74.39%

■ FIGURA 10.
Gjyqtari ose personeli tjetër i gjykatës ka shpjeguar qartë rregullat e mirësjelljes në gjykatë në fillim të seancës gjyqësore.

Një tjetër aspekt i vëzhguar gjatë seancave gjyqësore ishte nëse gjyqtari ka bërë përmbledhje të procesit të seancës edhe në lidhje me seancën aktuale edhe si pjesë e procesit të përgjithshëm të gjykimit të çështjes. Të dhënat në tabelën në vijim tregojnë se në 84.87% të rasteve, gjyqtarët kanë dhënë përmbledhje të procesit dëgjimor si në lidhje me seancën aktuale ashtu edhe si pjesë e procesit të përgjithshëm të gjykimit të rastit, ndërsa në 15.13% të rasteve kjo nuk është bërë.

JO
143
15.13%



PO
802
84.87%

■ FIGURA 11.
Gjyqtari bëri një përmbledhje të procesit të seancës dëgjimore edhe në lidhje me seancën aktuale edhe si pjesë e procesit të përgjithshëm të gjykimit të çështjes.

Gjatë seancave gjyqësore, gjyqtarët janë monitoruar nëse kanë mbajtur kontakt me sy me palët gjatë seancës. Siç është paraqitur më poshtë, këtë e kanë bërë në 96.93%, ndërsa në 3.07% jo.



Gjyqtarët gjithashtu janë vëzhguar nëse kanë folur në mënyrë të qartë dhe të qetë. Nga të dhënat e vëzhgimit rezulton se kjo nuk përbënte sfidë, meqë në 98.84% të rasteve gjyqësore të monitoruara gjyqtari ka shfaqur sjellje profesionale, duke folur në mënyrë të qartë dhe të qetë.






Tabela në vijim tregon numrin/përqindjen e rasteve ku gjyqtari iu drejtua palëve me emër. Në 92.17% të rasteve gjyqtari iu drejtua palëve me emër duke shfaqur respekt ndaj tyre, ndërsa në 7.83% kjo nuk është bërë.



Një aspekt tjetër i vëzhguar ishte nëse gjyqtari u siguria që palët i kuptojnë të drejtat e tyre. Në 96.72% të rasteve gjyqtari është kujdesur që palët i kuptojnë të drejtat e tyre duke treguar mirëkuptim ndaj palëve, ndërsa në vetëm 3.18% kjo nuk është bërë.



Për më tepër, në 91.64% të rasteve të vëzhguara gjyqtarët kanë përshtuar qartë se çfarë duhet të bëjnë palët për t'i përmbushur pritjet, urdhrat e përkohshëm të gjykatës dhe/ose aktgjykimet, ndërsa në 8.63% nuk e kanë bërë.




Gjithashtu, siç është cekur më poshtë, palët janë lejuar të bëjnë pyetje ose komente në shumicën e rasteve të vëzhguara, në 92.7% të rasteve. Ndryshe, në 7.3% të rasteve ata nuk janë lejuar të bëjnë pyetje ose komente.



Në 82.22% të rasteve gjyqtari kërkoi nga palët që të përsërisin atë që kanë kuptuar për sa i përket rolit të tyre, veprimeve të kërkuara/hapave të radhës, përfshirë tarifatat që duhet t'i paguajnë, dokumentet që duhen dorëzuar etj., ndërsa në 17.78% të rasteve jo.


JO
168
17.78%



PO
777
82.22%


Tabela në vijim tregon se në 97.57% të rasteve gjyqtari ka përdorur gjuhë të thjeshtë për t'i shpjeguar termat juridik ose shkurtesat, ndërsa në një përqindje shumë të vogël të rasteve (2,43%) gjyqtari nuk ka përdorur gjuhë të thjeshtë për shpjegimin e termave juridik dhe shkurtesave.

JO
23
2.43%




PO
922
97.57%

Sipas vëzhgimeve të rasteve gjyqësore të D+, në pjesën më të madhe të rasteve të vëzhguara, 79.26%, palët janë konsultuar për datën e ardhshme të gjykimit, ndërsa në 20.74% të rasteve nuk janë konsultuar.



Aspekti i fundit i vëzhguar ishte nëse gjykata ishte në dijeni para seancës për nevojën për përkthim dhe nëse ky shërbim është ofruar me kohë. Nga të dhënat e vëzhgimit rezulton se përkthimi është ofruar me kohë në 153 raste ndërsa në 15 raste jo. Në përgjithësi, në 82.22% të rasteve gjyqësore nuk ka pasur nevojë për përkthim konsektiv.



Rekomandimet

Në përgjithësi, të dhënat e vëzhgimit tregojnë rezultate pozitive për zbatimin e drejtësisë procedurale në të gjitha degët e gjykatave në Kosovë. Megjithatë, rezultatet e degëve të gjykatave tregojnë se ato kanë performancë më të dobët në krahasim me gjykatat themelore, në kuptim të kohës së fillimit të seancës, prezantimit të gjyqtarit me emër, kërkimfaljes në rast të vonesës, ofrimit të shpjegimit për rregullat e mirësjelljes në gjykatë që në fillim të seancës, ofrimit të një përmblendhjeje të procesit dëgjimor edhe për sa i përket seancës aktuale edhe gjykimit të rastit në përgjithësi, mes tjerash. Një faktor shpjegues i rezultateve më të mira në gjykatat themelore mund të jetë numri dhe lloji i trajnimit bazik të cilin kanë pasur qasje gjyqtarët e gjykatave themelore, në krahasim me atë të degëve të gjykatave.

Bazuar në gjetjet e anketës së vëzhgimit dhe me qëllim të përmirësimit të zbatimit të drejtësisë procedurale në të gjitha degët e gjykatës në Kosovë, D+ ka përpiluar listën vijuese të rekomandimeve të politikave:

- **STANDARDIZIMI I PROCEDURAVE GJYQËSORE:** Duhet të ketë procedura të standardizuara të aplikueshme për të gjitha gjykatat për të siguruar që palët kanë trajtim të njëtrajtshëm. Kjo mund të përfshijë detyrimin që gjyqtarët të prezantohen, t'i vendosin emrat e tyre në bankë, si dhe të bëjnë përmblendhje të procesit dëgjimor. Po ashtu, kjo mund të përfshijë udhëzime për të kërkuar falje për vonesa dhe për t'i konsultuar palët para caktimit të datës së ardhshme të gjykimit.
- **TRAJNIME PËR GJYQTARËT:** Ka nevojë për programe gjithëpërfshirëse trajnimi për gjyqtarët, veçanërisht në fushën e drejtësisë procedurale dhe komunikimit efektiv. Trajnimi duhet të përqendrohet në rëndësinë e përshëndetjes së palëve, prezantimit të tyre, kërkimit të faljes për vonesë, shpjegimit të rregullave të mirësjelljes në gjykatë dhe referimit të palëve me emër. Përveç kësaj, trajnimi duhet ta theksojë nevojën për të përdorur gjuhë të thjeshtë dhe për t'i konsultuar palët para caktimit të datës së ardhshme të gjykimit.
- **TRAJNIME PËR STAFIN E GJYKATËS:** Të sigurohen trajnime shitesë për stafin e gjykatës për t'i përmirësuar shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe shërbimin për klientët, me fokus të veçantë në përshëndetjen e qytetarëve që hyjnë në sallë të gjykimit dhe shpjegimin e rregullave të mirësjelljes në gjykatë.
- **APLIKIMI I TEKNOLOGJISË:** Përdorimi i teknologjisë, siç janë sistemet elektronike të kalendarit dhe resurset elektronike për palët, mund të ndihmojë në mbarëvajtjen e procedurave të gjykatës dhe uljen e vonesave. Për më tepër, teknologjia mund të përdoret për të përmirësuar komunikimin me palët, si për shembull përmes përdorimit të mesazheve të automatizuara për t'i kujtuar palët për datat e ardhshme të gjykimit ose për të dërguar informata të reja mbi statusin e rastit të tyre.
- **DUHET TË KRYHET MONITORIM DHE VLERËSIM I RREGULLT I PROCEDURAVE GJYQËSORE:** Për të siguruar që gjyqtarët i ndjekin procedurat e standardizuara dhe se palët marrin trajtim të drejtë dhe të njëtrajtshëm. Kjo mund të përfshijë përdorimin e pyetësorëve për përdoruesit e gjykatës dhe anketa vëzhguese të gjykatës për të mbledhur informata mbi përvojat në gjykatë.
- **PROMOVIMI I DREJTËSISË PROCEDURALE:** Duhet t'i vihet theks më i madh promovimit të drejtësisë procedurale në sistemin gjyqësor. Kjo mund të përfshijë fushata të edukimit publik për të rritur ndërgjegjësimin për parimet e drejtësisë procedurale dhe rëndësinë e trajtimit të drejtë dhe të njëtrajtshëm në sistemin gjyqësor. Për më tepër, gjyqtarët duhet të inkurajohen që t'i japin përparësi drejtësisë procedurale në ndërveprimet e tyre me palët dhe ta komunikojnë rëndësinë e drejtësisë procedurale në gjykatë.

SHTOJCA I

Pyetje vëzhguese

-
- P J **1.** Personat që hynë në sallën e gjykimit janë përshëndetur nga stafi i gjykatës.
-
- P J **2.** Emri i gjyqtarit është vendosur dukshëm në bankë.
-
- P J **3.** Seanca(t) kanë filluar në kohë.
-
- P J **4.** Gjykatësi/ja u prezantua me emër.
-
- P J **5.** Në rast vonese, gjyqtari ka kërkuar falje për vonesën në fillimin e seancave.
-
- P J **6.** Gjyqtari ose personeli tjetër i gjykatës ka shpjeguar qartë rregullat e mirësjelljes në gjykatë në fillim të seancës gjyqësore.
-
- P J **7.** Gjyqtari bëri një përmbledhje të procesit të seancës dëgjimore edhe në lidhje me seancën aktuale edhe si pjesë e procesit të përgjithshëm të gjykimit të çështjes.
-
- P J **8.** Gjyqtari ka mbajtur kontakt me sy me palët gjatë seancës
-
- P J **9.** Gjyqtari paraqiti një sjellje profesionale, duke folur në mënyrë të qartë dhe të qetë.
-
- P J **10.** Gjyqtari iu referua palëve me emër.
-
- P J **11.** Gjyqtari u siguria që palët i kuptojnë të drejtat e tyre.
Nëse jo, shpjegoni pse:
-
- P J **12.** Të gjithë folësit - gjyqtarët, avokatët dhe palët ishin lehtësisht të dëgjueshëm.
-
- P J **13.** Gjyqtari ka përshkruar qartë se çfarë duhet të bëjnë palët për t'i përmbushur pritjet, urdhrat e përkohshëm dhe/ose vendimet e gjykatës.
-
- P J **14.** Palët u lejuan të bënin pyetje ose koment.
-
- P J **15.** Gjyqtari kërkoi nga palët të përsërisin atë që kanë kuptuar për sa i përket rolit e tyre, veprimeve të kërkuara/hapave të përfshirë tarifat që duhet të paguajnë, dokumentet që duhen dorëzuar, etj.
-
- P J **16.** Gjykatësi përdori gjuhë të thjeshtë për të shpjeguar termat ose shkurtesat ligjore.
-
- P J **17.** Palët janë konsultuar për caktimin e datës së ardhshme të gjykimit.
-
- P J **18.** Gjykata ishte në dijeni për nevojën për interpretimit para seancës dhe e ofronte atë me kohë. (Rretho këtu nëse nuk ishte i nevojshëm përkthimi)
-



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA